

Përmbledhje

Përkeqësimi i krizës shëndetësore si pasojë e valës së tretë të shpërndarjes së virusit Covid-19, dhe masat kufizuese të ndërmarra në vendet e eurozonës rezultuan në tkurrje të aktivitetit ekonomik prej -5.0 përqind në TM4 2020. Me krizë ekonomike është ballafaquar edhe rajoni i Ballkanit Perëndimorë. Në TM3 2020 është vlerësuar rënie ekonomike prej -8.5 përqind në këtë rajon, ndërsa parashikimet e FMN-së për vitin 2020 sugjerojnë rënie të aktivitetit ekonomik prej mesatarisht -6.9 përqind.

Bazuar në vlerësimet e ASK-së, BPV-ja reale në Kosovë deri në shtator 2020 shënoi rënie prej -5.6 përqind. Me rënie janë karakterizuar investimet dhe eksportet neto, ndërsa konsumi vlerësohet të ketë shënuar rritje. Në TM4 2020, indikacionet sugjerojnë për rënie më të vogël krahasuar me tremujorët paraprak. Këto vlerësime mbështeten në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në periudhën raportuese, rritjen e konsumit publik, rritjen e remitencave, etj. Në anën tjetër, investimet publike, qarkullimi i bizneseve dhe kreditë e reja investuese u karakterizuan me rënie të konsiderueshme.

Dinamikat e çmimeve në vend u shoqëruan me rënie në çmimet e konsumit prej -0.1 përqind në TM4 2020, kryesisht si pasojë e rënies së çmimeve të transportit, veshmbathjes, rekreacionit, orendive shtëpiake, etj. Rritje të ngadalësuar të çmimeve kanë shënuar çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, duke rezultuar në deflacion bazë prej 0.8 përqind.

Zbutja e efekteve negative të pandemisë Covid-19 në zhvillimet ekonomike ka ndikuar në përmirësimin e performancës së të hyrave buxhetore krahasuar me tremujorët paraprak. Të hyrat buxhetore në TM4 2020 shënuan rënie prej -0.6 përqind (-13.5 përqind në TM3

2020), përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 8.6 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 280.5 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.5 miliardë euro, që është për 23.9 përqind më i lartë krahasuar me TM4 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind, nga 17.5 përqind sa ishte në TM4 2019.

Asetet e sistemit financiar u rritën për 236.8 milionë euro në TM4 2020 si rezultat i rritjes së aseteve të sektorit bankar dhe sektorit të sigurimeve. Rritja e aseteve të sektorit bankar reflekton kryesisht rritjen e depozitave, që mund t'i atribuohet deri në një masë tërheqjes së 10 përqindëshit nga sistemi pensional. Sektori i sigurimeve shënoi rritje të aseteve, nivel më të lartë të primeve të shkruara dhe ulje të nivelit të dëmeve të paguara. Kurse, tkurrja e aseteve të sektorit pensional kryesisht i'u atribuua tërheqjes së 10 përqindëshit të kursimeve pensionale në fund të vitit 2020. Edhe sektori mikrofinanciar ka shënuar tkurrje të aseteve, megjithëse vazhdon të ketë cilësi të mirë të portfolios kreditore.

Sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse prej 56.8 përqind në TM4 2020. Bilanci pozitiv i shërbimeve si dhe të ardhurat parësore dhe dytësore kanë shënuar rritje të konsiderueshme, ndërsa deficitin e mallrave është përmirësuar. Deficiti tregtar i mallrave ishte 836.2 milionë euro apo 2.0 përqind më i ulët krahasuar me TM4 2019, dinamikë që kryesisht i'u atribuua rritjes së konsiderueshme të eksportit, përkundër rritjes së importit. Në kuadër të bilancit të pagesave, rritje të konsiderueshme në TM4 2020 kanë shënuar edhe remitencat dhe IHD-të (26.3 përqind përkatësisht 82.2 përqind).

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	4
Ekonomia e Kosovës -----	6
Sektori Real -----	6
Çmimet -----	6
Sektori Fiskal -----	7
Sektori Financiar -----	8
Sektori i Jashtëm -----	9

FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Norma e rritjes së BPV-së dhe inflacionit në Eurozonë-----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	06
Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj-----	09
Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave-----	10
Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 8. Remitencat-----	11
Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte-----	11
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në Ballkanin Perëndimor-----	05
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor-----	05
Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin-----	07
Tabela 4. Treguesit e zgjedhur makroekonomik-----	13

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BQE	Banka Qendrore Evropiane
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
MF	Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Përkeqësimi i krizës shëndetësore me valën e re të shpërndarjes së Covid-19 ndikoi që vendet e eurozonës të ndërmarrin sërish masa kufizuese të lëvizjes dhe aktiviteteve, gjë që rezultoj në tkurrje të aktivitetit ekonomik prej -5.0 përqind në TM4 2020 (figura 1).



Burimi: Eurostat (2021)

Në mesin e vendeve kryesore të Eurozonës, Gjermania dhe Franca raportuan rënie të aktivitetit ekonomik prej -3.9 përqind përkatësisht -5.0 përqind, përderisa Italia dhe Spanja rënie edhe më të lartë të aktivitetit ekonomik prej -6.6 përqind përkatësisht -9.1 përqind. Për vitin 2021, BQE parashikon rikuperim të aktivitetit ekonomik dhe rritje të BPV-së prej 3.9 përqind, bazuar në supozimin e heqjes graduale të masave kufizuese dhe rritjes së besueshmërisë si rezultat i supozimit mbi vaksinimin masiv brenda vitit.

Rënia e aktivitetit ekonomik u përkthye në dinamika të dobëta edhe në nivelin e çmimeve në eurozonë, kryesisht si pasojë e rënies së çmimeve të energjisë dhe rënies së çmimeve të prodhimeve industriale. Shkalla mesatare e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të

Konsumit në TM4 2020 ishte -0.3 përqind (1.0 përqind në TM4 2019). Si përgjigje ndaj rënies së çmimeve si dhe për të krijuar kushte të favorshme të financimit me qëllim të rikuperimit ekonomik, në dhjetor 2020, Këshilli Drejtues i BQE-së vendosi që në kuadër të Programit Pandemik të Blerjes së Aseteve të rrisë shumën në 1,850 miliardë euro dhe të lehtësoj kushtet për rifinancim afatgjatë. Po ashtu, këshilli drejtues i BQE-së vendosi t'i mbajë të pandryshuara normën e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.50 përqind).

Në anën tjetër, aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 6.4 përqind gjatë TM4 2020, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.5 përqind. Me rritje të lartë janë karakterizuar edhe depozitat, ku depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 20.7 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 8.7 përqind.

Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor u goditën nga pandemia Covid-19, duke u futur në një recesion të thellë. Sipas të dhënave nacionale, rënia më e lartë ekonomike është shënuar në TM2 2020 (mesatarisht -12.2 përqind), ndërsa në TM3 2020¹ aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizua me rënie mesatare prej -8.5 përqind. Rënia më e lartë ekonomike është shënuar në Mali të Zi, vend me varësi të lartë nga turizmi që njëherësh edhe përbën sektorin më të goditur nga kriza

¹ Të dhënat për TM4 2020, për shumicën e vendeve, nuk janë publikuar ende.

pandemike. Edhe Kosova shënoi rënie të konsiderueshme të aktivitetit ekonomik, kryesisht si pasojë e rënies së vizitave të diasporës me kufizimet e ndërmarra në lëvizje në vendet kryesore të eurozonës ku edhe janë më të koncentruar diaspora. Vendi që rezultoi të jetë ndikuar më pak nga kriza pandemike është Serbia (tabela 1).

Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në B. Perëndimor

Përshkrimi	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3
Serbia	2.6	2.9	4.9	6.3	5.2	-6.3	-1.4
Mali i Zi	3.2	3.6	5.2	3.7	2.6	-20.3	-26.9
Kosova	4.2	4.1	4.4	3.9	1.3	-9.3	-7.3
Maqedonia e Veriut	1.4	4.3	3.6	3.3	0.9	-14.9	-3.3
Shqipëria	2.3	2.3	4.2	0.0	-2.3	-10.2	-3.5

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sfidat që shoqëruan krizën pandemike dhe pasiguritë rreth ecurisë së vaksinimit të masës kanë ndikuar që FMN të parashikoj një rënie të aktivitetit ekonomik për mesatarisht -6.9 përqind në vitin 2020. Për vitin 2021, parashikimet e FMN-së sugjerojnë rikuperim të aktivitetit ekonomik me një rritje mesatare të BPV-së prej mesatarisht 5.6 përqind.

Presione të dobëta inflacioniste u raportuan edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si rezultat i rënies së kërkesës së brendshme dhe rënies së çmimeve të naftës. Norma mesatare e inflacionit në TM4 2020 ishte 0.9 përqind. Në Kosovë dhe Mal të Zi është shënuar deflacion, ndërsa në vendet tjera të rajonit norma e inflacionit ishte më e lartë (tabela 2).

Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit në B. Perëndimor

Përshkrimi	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4
Kosova	3.2	3.3	2.6	1.7	1.1	0.2	-0.4	-0.1
Mali i Zi	0.4	0.5	-0.1	1.1	0.5	-1.1	-1.4	-1.3
Maqedonia e Veriut	1.2	1.2	0.6	0.0	0.6	0.5	1.5	2.2
Serbia	2.4	2.3	1.3	1.4	1.7	1.0	1.9	1.6
Shqipëria	2.0	1.5	1.5	1.6	1.9	2.4	2.2	2.2

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, vendet e Ballkanit Perëndimorë shënuan rritje të aktivitetit

kreditues prej 6.5 përqind, që është normë më e ulët e rritjes krahasuar me normën prej 7.3 përqind në TM4 2019. Vendet të cilat shënuan normat më të larta të rritjes ishin Serbia dhe Kosova (10.8 përqind përkatësisht 7.1 përqind), pasuar nga Shqipëria (6.6 përqind), Maqedonia e Veriut (4.7 përqind) dhe Mali i Zi (3.2 përqind). Depozitat shënuan rritje mesatare prej 7.8 përqind, që është normë më e lartë krahasuar me rritjen prej 7.4 përqind në TM4 2019. Edhe tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Serbi dhe Kosovë (16.4 përqind përkatësisht 11.5 përqind), pasuar nga Shqipëria (8.3 përqind) dhe Maqedonia e Veriut (5.9 përqind), përderisa Mali i Zi raportoi rënie të shkallës së rritjes së depozitave (-3.0 përqind).


Gjatë TM4 2020, euro është zhvlerësuar ndaj frankës zvicerane (1.7 përqind) ndërsa është vlerësuar ndaj valutave tjera: 46.5 përqind ndaj lirës turke, 7.7 përqind ndaj dollarit amerikan, 5.0 përqind ndaj sterlinës britanike, 1.6 përqind ndaj kunës kroate, 0.9 përqind ndaj lekut shqiptar, etj.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Për të menaxhuar me pandeminë Covid-19, sikurse qeveritë tjera, edhe qeveria e Kosovës ka ndërmarr masa kufizuese në aspekt të lëvizjes, udhëtimit, aktiviteteve publike dhe jopublike, veprimtarive në disa prej shërbimeve të ndërmarrjeve, etj. Masat kufizuese të ndërmarra kanë rezultuar në rënie mesatare të aktivitetit ekonomik prej -5.6 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2020. Në kuadër të BPV-së, komponentat e investimeve dhe eksporteve neto janë zvogëluar me -6.5 përkatësisht -6.4 pikë përqindje. Në anën tjetër, aktiviteti ekonomik u mbështet nga kontributi pozitiv i konsumit me 7.4 pikë përqindje (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK -së (2021)

Sipas ASK-së, rënien më të lartë e shënuar sektori i hoteleve dhe restoranteve (-30.7 përqind), transporti dhe magazinimi (-30.2 përqind), ndërtimtaria (-28.6 përqind), aktiviteteve administrative dhe mbështetëse (-12.4 përqind), tregtia (-8.9 përqind), etj. Në anën tjetër, rritja më e lartë është shënuar tek sektori i shëndetësisë dhe punës sociale (12.7 përqind),


furnizimit me energji elektrike dhe gaz (12.2 përqind), industria përpunuese (12.0 përqind), informimit dhe komunikimit (10.5 përqind), industria nxjerrëse (4.4 përqind), etj.

Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se në TM4 2020 është shënuar rënie më e ngadalësuar e aktivitetit ekonomik prej -3.8 përqind, kundrejt rënies së shënuar në dy tremujorët paraprak të vitit. Këto vlerësime mbështeten në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në periudhën raportuese, rritjen e konsumit publik dhe rritjen e remitencave. Në anën tjetër, investimet publike, qarkullimi i bizneseve dhe kreditë e reja investuese shënuan rënie të konsiderueshme.

Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje të ngadalësuar prej 0.2 përqind në vitin 2020 (2.7 përqind rritje në 2019). Duke filluar nga muaji korrik, është raportuar nga ASK për rënie të çmimeve, përdërisa mesatarja e deflacionit në TM4 2020 ishte 0.1 përqind (figura 3).

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2021)

Rënie e çmimeve në TM4 2020 është shënuar tek çmimet e transportit, të veshmbathjes, çmimet e rekreacionit si dhe çmimet e orendive shtëpiake. Në anën tjetër, rritje kanë shënuar çmimet e mjeteve të komunikimit, shërbimet shëndetësore, shërbimet e hotelerisë, etj. Me rritje të ngadalësuar të çmimeve janë karakterizuar edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, mirëpo, për shkak të peshës së madhe në shportën e konsumatorit kosovarë, kontribuuan pozitivisht me 0.65 pikë përqindje në nivelin e përgjithshëm të çmimeve (tabela 3).

Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej deflacionin gjatë TM4 2020

Përshkrimi	Peshat 2020	Norma e deflacionit	Kontributi
<i>GJITHSEJ</i>	100.0%	-0.1	-0.13
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	40.1%	1.6	0.65
Pijet alkoolike dhe duhani	5.7%	0.4	0.03
Veshmbathja	4.1%	-2.1	-0.08
Energjia	7.7%	0.5	0.04
Orenditë	7.6%	-0.4	-0.03
Shëndetësia	2.1%	4.4	0.09
Transporti	15.7%	-7.3	-1.16
Komunikimi	3.8%	5.2	0.18
Rekreacioni	4.4%	-0.4	-0.02
Arsimi	1.0%	0.5	0.00
Hoteleria	3.2%	1.6	0.05
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.5%	2.0	0.12

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Siç shihet në tabelë, shporta e konsumatorit kosovar karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan), dhe përjashtimi i këtyre komponentëve rezultoi në deflacion bazë edhe më të lartë se sa deflacioni i përgjithshëm (figura 3). Deflacioni bazë rezultoi të jetë 0.8 përqind, apo 0.7 pikë përqindje më i lartë se sa deflacioni i përgjithshëm.

Për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamikat e shportës së konsumatorit

kosovarë përcaktohen kryesisht nga lëvizja e çmimeve të importit, të cilat në TM3 2020 shënuan rënie mesatare prej -2.3 përqind (2.2 përqind rritje në TM3 2019). Përveç çmimeve të importit, me rënie prej -0.8 përqind janë karakterizuar edhe çmimet e prodhimit por që kjo normë e rënies ishte më e ulët krahasuar me çmimet e importit.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore² deri në dhjetor 2020 arritën vlerën neto prej 1.7 miliardë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 8.8 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore³ shënuan një rritje vjetore prej 6.5 përqind dhe arritën vlerën prej 2.2 miliardë euro. Vetëm në TM4 2020, të hyrat buxhetore ishin 505.9 milionë euro, apo 0.6 përqind më të ulëta krahasuar me TM4 2019, ndërsa shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 8.6 përqind dhe arritën vlerën prej 786.4 milionë euro. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 280.5 milionë euro gjatë këtij tremujori.

Zbutja deri në një masë e efekteve negative në ekonominë e vendit në TM4 2020 rezultoi në ketë ndikuar në një rritje të lehtë të të hyrave tatimore direkte prej 0.4 përqind. Tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje prej 2.9 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rënie prej -6.4 përqind. Ndikimi negativ i pandemisë mbi kërkesën e brendshme dhe importet e mallrave është reflektuar në rënie prej -3.3 përqind në të hyrat tatimore indirekte, kategori që dominon të hyrat buxhetore me rreth 73 përqind. Në TM4 2020, të hyrat tatimore indirekte

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga financimi.

³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

shënuan vlerën prej 368.1 milionë euro, ku TVSH-ja dhe akciza si dy kategoritë kryesore të kësaj kategorie shënuan rënie prej -1.4 përqind përkatësisht -3.1 përqind.

Masat e ndërmarra nga Qeveria për të zbutur efektet negative ekonomike dhe sociale nga kriza shëndetësore e pandemisë Covid-19 rezultuan në rritje të shpenzimeve buxhetore. Kategoria kryesore që kontribuoi në rritjen e shpenzimeve buxhetore gjatë TM4 2020 ishte ajo e subvencioneve dhe transfereve, e cila arriti vlerën prej 322.0 milionë euro apo 77.3 përqind më shumë krahasuar me TM4 2019. Me rritje prej 7.4 përqind u karakterizuan edhe shpenzimet për paga, të cilat arritën nivelin prej 170.4 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje prej 5.2 përqind dhe arritën vlerën 118.0 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet kapitale shënuan rënie për -35.3 përqind dhe shënuan vlerën 176.0 milionë euro.

Borxhi publik në TM4 2020 ka arritur në 1.5 miliardë euro, që është për 23.9 përqind më i lartë krahasuar me TM4 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind, nga 17.5 përqind sa ishte në TM4 2019. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 21.5 përqind (që ka arritur në 961.9 milionë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik për 28.6 përqind (që ka arritur në 525.8 milionë euro). Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin publik është rritur në 35.3 përqind nga 34.0 përqind sa ishte në TM4 2019. Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind e BPV-së, rrjedhimisht niveli i borxhit publik

prej 21.8 përqind e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sidoqoftë, ky nivel i ulët i borxhit publik mund të rritet shpejt në të ardhmen si rezultat ndikimeve negative të pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës dhe planeve të qeverisë për ta financuar deficitin buxhetor nëpërmjet borxhit publik.

Sektori Financiar⁴

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 236.8 milionë euro, kryesisht ndikuar nga aktiviteti i sektorit bankar dhe sektorit të sigurimeve. Rritja e theksuar e aseteve të sektorit bankar në këtë tremujor reflekton kryesisht aktivitetin në depozita, si rrjedhojë e transferimit të mjeteve nga sektori pensional (10 përqindëshit) në llogari të qytetarëve dhe rritjes së nivelit të depozitave prej korporatave jofinanciare.

Në kuadër të sektorit bankar, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rritjen më të lartë, pasuar nga aktiviteti kreditues dhe investimet në letrat me vlerë. Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat, si burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar, shënuan rritjen më të theksuar në këtë tremujor. Me rritje u karakterizuan edhe kategoria e burimeve vetanake (nga fitimi i mbajtur dhe i realizuar). Sa i përket shëndetit të sektorit bankar, edhe gjatë TM4 2020, sektori ruajti nivele të larta të kapitalit, treguesve të likuiditetit dhe cilësisë së lartë të portfolios kreditore.

Sektori pensional u karakterizua me tkurrje të aseteve në TM4 2020, kryesisht si rezultat i tërheqës së 10

⁴ Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM4 2020) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

përqindëshit të kursimeve pensionale në fund të vitit, dinamikë që u neutralizua deri në një masë nga kontributet e arkëtuara dhe kthimi pozitiv në investime.

Me rritje të aktivitetit u karakterizua edhe sektori i sigurimeve gjatë TM4 2020, reflektuar kryesisht përmes rritjes së aseteve, nivelit më të lartë të primeve të shkruara dhe uljes së nivelit të dëmeve të paguara krahasuar me TM4 2019.

Sektori mikrofinanciar ka shënuar tkurrje të aktivitetit në TM4 2020 kundrejt vitit paraprak, dinamikë që në masë të madhe pasqyron revokimin e licencës së dy institucioneve mikrofinanciare/financiare jo-bankare gjatë vitit të kaluar, asetet e të cilave janë duke u zbritur gradualisht nga bilanci i gjithsej sektorit. Gjithashtu, në rënien e përgjithshme të aktivitetit të sektorit mikrofinanciar kanë ndikuar edhe efektet negative të pandemisë Covid-19.


Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë dukshëm më të lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e nivelit të borxhit sovran të emetuar reflekton nevojat e Qeverisë së Kosovës për të financuar aktivitetin e saj përmes këtij instrumenti.

Sektori i Jashtëm

Kanali kryesor përmes së cilit është transmetuar kriza ekonomike dhe sociale e nxitur nga pandemia Covid-19 në Kosovë ka qenë sektori i jashtëm i ekonomisë. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vitin 2020 është rritur për 7.5 përqind dhe ka arritur vlerën prej 429.4 milionë

euro. Në raport me BPV-në, deficiti i llogarisë rrjedhëse arriti në -6.4 përqind nga -5.6 përqind në vitin 2019. Nëse analizojmë TM4 si të izoluar, vërejmë tendencë më pozitive krahasuar me pjesën tjetër të vitit, ecuri që rezulton të jenë përkthyer në rënie të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 56.8 përqind krahasuar me TM4 2019. Në kuadër të bilancit të pagesave, bilanci pozitiv i shërbimeve si dhe të ardhurat parësore dhe dytësore kanë shënuar rritje të konsiderueshme, ndërsa deficiti i mallrave është përmirësuar (figura 4).

Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro




Burimi: BQK (2021)

Rritja e eksportit të mallrave si dhe rënia e konsiderueshme e importit si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik ka ndikuar që deficiti në tregtinë e mallrave⁵ të shënoj vlerën prej 2.8 miliardë euro, që përkon me një rënie prej -9.4 përqind. Vetëm në TM4 2020, deficiti tregtar i mallrave ishte 836.2 milionë euro apo 2.0 përqind më i ulët krahasuar me TM4 2019. Kjo rënie e deficitit të mallrave i atribuohet kryesisht rritjes së konsiderueshme të eksportit, përkundër rritjes së importit të mallrave.

⁵ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Vlera e eksportit të mallrave në TM4 2020 ishte 143.2 milionë euro, një rritje vjetore prej 51.2 përqind (figura 5).


Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK (2021)

Rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar tek metalet bazë dhe perimet, ndërsa rënie shënuan lëkura dhe artikujt e lëkurës, yndyrat dhe vajrat ushqimorë, etj. (figura 6).

Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2021)

Vlera e importit të mallrave arriti në 979.4 milionë euro në TM4 2020, që paraqet rritje prej 3.3 përqind. Në rritjen e importit ka ndikuar kryesisht niveli më i lartë i importit të produkteve të industrisë kimike. Me rritje është karakterizuar edhe importi i ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit si dhe import i

plastikës dhe gomës. Në anën tjetër, importi i produkteve minerale, importi i mjeteve të transportit, importi i perimeve, etj. u karakterizuan me rënie (figura 7).

Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2021)


Në kuadër të bilancit të pagesave, tregtia me shërbime ishte komponenta që pësoi rënie më të madhe si pasojë e drejtpërdrejtë e masave kufizuese të ndërmarrja për të menaxhuar me krizën shëndetësore. Bilanci në tregtinë e shërbimeve, në vitin 2020, shënoi vlerën prej 430.2 milionë euro apo 53.5 përqind më pak krahasuar me vitin 2019. Kjo rënie e eksportit të shërbimeve përbën njërin prej kanaleve të jashtme kryesore të transmetimit të krizës, pasi që eksporti i shërbimeve ka një pjesëmarrje të lartë në BPV dhe përbëhet kryesisht nga shpenzimet e diasporës gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë. Për dallim nga zhvillimet në tremujorët paraprak, në TM4 2020 bilanci i shërbimeve është rritur për 47.4 përqind. Vlera e eksportit të shërbimeve shënoi rritje prej 9.0 përqind dhe arriti vlerën prej 287.0 milionë euro.

Rritja e vizitave të diasporës në Kosovë për festat e fund vitit ka ndikuar që eksporti i shërbimeve të udhëtimit të arrijë vlerën prej 183.1 milionë euro në

TM4 2020, që përkon me një rritje vjetore prej 2.3 përqind. Me rritje janë karakterizuar edhe shërbimet tjera, si: eksporti i shërbimeve pensionale dhe të sigurimit, shërbimet e ndërimit, shërbimet e transportit, etj. Në anën tjetër, importi i shërbimeve ka vazhduar trendin rënës edhe në TM4 2020, ku vlera e shërbimeve të importuara ishte 153.0 milionë euro, apo 11.3 përqind më pak krahasuar me TM4 2019. Rënia më e lartë është shënuar tek importi i shërbimeve kompjuterike (-43.5 përqind), shërbimeve të udhëtimit (-24.0 përqind), si dhe shërbimeve të transportit (-12.1 përqind).

Llogaria e të ardhurave parësore shënoi rritje prej 11.7 përqind në TM4 2020, kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave nga investimet, ndërkohë që të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve shënuan rënie. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 21.8 përqind, kryesisht si rezultat i nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që paraqesin kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 283.1 milionë euro në TM4 2020, një rritje vjetore prej 26.3 përqind (figura 8).

Figura 8. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2021)

Rritja e remitencave ka qenë dyshifrore gjatë gjithë vitit 2020, me përjashtim të muajit mars dhe prill 2020 kur shënuan rënie. Sa i përket kanaleve të transferimit, pjesa dërmuese e remitencave (61.5 përqind) kanë ardhur përmes agjencive për transfer të mjeteve, të cilat shënuan rritje prej

54.4 përqind në TM4 2020. Remitencat përmes bankave shënuan rritje prej 29.1 përqind, ndërsa remitencat përmes 'kanalit jo-formal' shënuan rënie për 13.6 përqind. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat u dërguan 42.9 përqind, përkatësisht 20.0 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të (6.7 përqind e gjithsej remitencave).

Investimet e Huaja Direkte (IHD), në TM4 2020, arritën vlerën prej 69.6 milionë euro, që paraqet një rritje prej 82.2 përqind. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, investimet në kapital dhe fond të investimeve në aksione shënuan rritje prej 49.6 përqind, ndërsa tek instrumentet e borxhit rënia ishte më e ulët për 46.7 përqind krahasuar me TM4 2019 (figura 9).

Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte, në milionë euro



Burimi: BQK (2021)

Rritje e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e aktiviteteve financiare dhe në sektorin e patundshmëri, sektor që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e IHD-ve. Rritja e IHD-ve në patundshmëri gjatë TM4 2020 i është atribuar deri në një masë rritjes së numrit të vizitave të diasporës në këtë periudhë, përderisa rritja e IHD-ve në sektorin e aktiviteteve financiare kryesisht reflekton mos-shpërndarjen e dividendës në këtë fazë dhe për pasojë, shkak të mos shpërndarjes së dividendës.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2021): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 33, TM4 2020, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK (2021):

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: [Letrat me Vlerë të Qeverisë | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK (2021):

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: [Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit \(IHÇK\), Shkurt 2021 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimit \(IÇP\), TM4 2020 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [Indeksi i Çmimeve të Importit \(IÇIMP\), TM4 2020 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: [Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë, TM3 2020 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: [Statistikat e Tregtisë së Jashtme \(STJ\), Janar 2021 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)

IMF (2021): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	5,212.7	4,902.3
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	2.7%	0.2%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.1%	0.1%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,888.2	1,721.2
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	2,070.0	2,205.2
Bilanci primar (në milionë euro)	-181.8	-484.1
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,259.9	7,907.8
prej të cilave: Bankat	4,760.5	5,353.1
Kredi	3,031.9	3,246.4
Depozita	3,908.1	4,358.8
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.42%	6.01%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.60%	1.52%
Hendeku i normës së interesit	4.8%	4.5%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-399.5	-429.4
prej të cilave: remitencat e pranuar	851.7	980.1
Llogaria financiare	-163.0	-502.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	254.6	321.7
Investimet portfolio, net	59.0	-81.6
Investimet tjera, net	-128.8	-195.3
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-304.6	-773.6
Asetet	5,185.2	5,198.6
Detyrimet	5,489.8	5,972.2
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,160.9	2,381.1
Borxhi i jashtëm privat	1,662.1	1,883.7
Borxhi i jashtëm publik	498.8	497.4

Burimi:

1/ ASK (2020).

2/ MF (2020).

3/ BQK (2020).

*Të dhënat për PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në shtator 2020.

